



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 81.të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale si dhe Kërkesës së MAPL/MMPH-Nr.020-803/10 të dt.02.08.2018, për Rishqyrtim të vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.06-4722/2018 të dt.04.07.2018 Për Caktimin e Lokacionit për ndërtim të Qerdhes së fëmijëve në zonën kadastrale në Deiq, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të rregullt për vitin 2018, të mbajtur me datën 21.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

- I. Rishqyrtohet, vendimi i Kuvendit të Komunës së Klinës 01Nr.06-4722/2018 të dt.04.07.2018 Për Caktimin e Lokacionit për ndërtim të Qerdhes së Fëmijëve në Zonën Kadastrale Deiq, Komuna e Klinës.
- II. Kuvendi mbështet unanimitisht Vendimin si në pikën 1 si dhe sqarimet nga Komuna e Klinës sipas shkresës 01Nr.06-5543/2018 të datës 20.08.2018
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet edhe Shkresa sqaruese e Komunës së Klinës 01Nr.06-5543/2018 të datës 20/08/2018.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës.
- V. Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyra e Informimit, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-6318 2018
Klinë, me 27.09. 2018





PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Prishtinë;
Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë;

NGA: Komuna e Klinës, kryetari, z. Zenun Elezaj;

LËNDA: shkresë sqarues lidhur me kërkesën tuaj të datës 02.08.2018 për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të Kuvendit të Komunës së Klinës, nr.06-4722/2018 të miratuar me datën 29.06.2018;



Te nderuar,

Duke marrë parasysh kërkesën tuaj, nr.020-803/9 të datës 02.08.2018 e të pranuar nga Komuna e Klinës po të njëjtën datë, që ka të bëjë me rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Klinës, nr.06-4722/2018 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhës së fëmijëve në fshatin Deiq Komuna e Klinës, në parcelën kadastrale nr.55/1, ju njoftojmë dhe sqarojmë, si në vijim:

Komuna e Klinës është mbështetur nga një donacion për ndërtimin e një çerdhë në Klinë, andaj me qëllim të realizimit të këtij projekti në interes të qytetareve është identifikuar si pronë e Komunës së Klinës parcela e lartcekur dhe me vendim të Kuvendit të Komunës është caktuar si lokacion për ndërtimin e çerdhës.

Në bazë të shkresës suaj është theksuar se ky vendim është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe duhet rishqyrtuar, pasi që në vendim nuk figuron dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi, me të cilin parashihet destinimi apo shfrytëzueshmëria e lokacionit të planifikuar për ndërtimin e çerdhës së fëmijëve.

Me dokumente të planifikimit nuk është destinuar dhe planifikuar ndërtimi i çerdhës së fëmijëve në zonën kadastrale 55/1 në Deiq, pasi që neper vendbanime rurale nuk janë planifikuar ndërtimet, andaj me qëllim të përfitimit të donacionit dhe realizimit të projektit në interes të qytetareve është marrë vendim në Kuvendin e Komunës për caktimin e këtij lokacioni për ndërtimin e çerdhës, pasi që sikur të ishte parapare me plan zhvillimor nuk do të ishte nxjerr fare vendim në Kuvendin e Komunës.

Ligji për vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, si dhe Rregullorja e MAP-it për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nr.01/2017, e përcaktojnë qartë se autoriteti mbikëqyrës obligohet që ta jap mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij. Nëse brenda këtij afati Ministria nuk jep përgjigje, atëherë Komuna e bene publikimin e aktit në ueb faqen zyrtare të Komunës, të cilat akte hynë në fuqi 7 dite pas publikimit të tyre në ueb faqe.

Komuna e Klinës me datën 06.07/2018 e ka dërguar aktin për shqyrtimin e ligjshmërisë, ndërsa MAPL si përgjegjëse që brenda afatit ligjor prej 15 ditësh të bëjë vlerësimin dhe ta njoftojë komunën, të cilin obligim ministria përgjegjëse nuk e ka kryer në afatin e parapare ligjor, andaj në përputhje me dispozitat ligjore pozitive Komuna e Klinës, me datën 27.07/2018 ka bërë publikimin e aktit në ueb faqen e Komunës, i cili ka hyrë në fuqi me datën 04.08/2018.

Me respekt,

01Nr. 06-5543 /2018
Klinë, dt.20/08/2018